



BASHKIA GRAMSH



Draft/Plani i Arsimit Parauniversitar

2026 -2028

1. Hyrje dhe konteksti.....	6
Konteksti administrativ	6
Të dhëna demografike	7
Struktura e popullsisë së re:	7
Kudri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor	8
2. Analiza e shërbimit të arsimit PARAUNIVERSITAR në vitin shkollor 2024 – 2025	10
3. Analiza e ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025.....	10
Frekuentimi	11
Shërbimi psiko-social në arsimin parashkollor	11
4. Analiza e shërbimit në shkollat e arsimit bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025	12
Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit.....	12
Frekuentimi sipas niveleve arsimore	13
Arsimi fillor	13
Arsimi 9-vjeçar	13
Arsimi i mesëm.....	14
5. Shërbimi i Arsimit sipas njësive administrative	14
Njësia Administrative Pishaj	14
Njësia Administrative Kodovjat	14
Njësia Administrative Kukur.....	15
Njësia Administrative Kushovë.....	15
Njësia Administrative Lenie	15
Njësia Administrative Poroçan	16
Njësia Administrative Skënderbegas.....	16
Njësia Administrative Sult.....	16
Njësia Administrative Tunjë.....	16
Njësia Administrative Gramsh (Qendra).....	17
6. Burimet njerëzore në Arsimin Parauniversitar dhe shërbimet mbështetëse	17
7. Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar	18
Vizioni.....	18
8. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar	20
Arsimi bazë përfshi arsimin parashkollor	20
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	20
9. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)	22
10. Plani i investimeve kapitale	35
11. Monitorimi dhe vlerësimi	36
Indikatorët e Performancës.....	36

Planifikimi i vlerësimit të progresit.....	36
Përfshirja e aktorëve të jashtëm	36
Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimi.....	36
Monitorimi i realizimit të aktiviteteve	36
Vlerësimi i ndikimit në komunitet	37
12. Rishikimi dhe përshtatja e planit	37
Procesi i rishikimit	37
Përshtatja e masave dhe aktiviteteve	38
13. Raportimi dhe transparenca	38
14. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar	39
15. Aneks 2: Numri i banorëve sipas njësive administrative dhe gjinisë (Censusi 2023).....	40
16. Aneks 3 Numri i banorëve të rinj sipas njësive administrative dhe grupmoshës.....	41
17. Aneks 4 Numri i banorëve të rinj sipas grupmoshës	42
18. Aneks 5 Numri shkollave (sipas kategorisë) dhe numri i kopshteve, sipas njësive administrative	
42	

Parathënie

Bashkia Gramsh e konsideron arsimin si themelin e zhvillimit të qëndrueshëm, mirëqenies dhe perspektivës së komunitetit tonë. Ky Plan për Arsimin Parauniversitar përfaqëson një dokument strategjik që udhëzon veprimet tona për periudhën në vijim, duke synuar krijimin e një sistemi arsimor cilësor, të sigurt dhe të aksesueshëm për çdo fëmijë dhe nxënës në territorin e bashkisë.

Vizioni ynë është të ndërtojmë një sistem arsimor parauniversitar cilësor, modern dhe gjithëpërfshirës, që u garanton të gjithë fëmijëve e nxënësve kushte optimale për të mësuar, për t'u rritur dhe për t'u zhvilluar në bashkëpunim me familjen dhe komunitetin.

Në qendër të këtij plani qëndron angazhimi ynë për të siguruar infrastrukturë të përmirësuar, pajisje bashkëkohore, shërbime mbështetëse dhe staf të kualifikuar. Përmes objektivave të qarta dhe të matshme, synojmë të forcojmë cilësinë e edukimit parashkollor, të arsimit bazë dhe atij të mesëm të përgjithshëm, duke nxitur përfshirjen sociale, mbështetjen psiko-sociale dhe bashkëpunimin e ngushtë midis shkollës, familjes dhe komunitetit.

Ky dokument është rezultat i një procesi të gjerë konsultimi dhe analize, duke reflektuar nevojat reale të institucioneve tona arsimore dhe prioritetet e zhvillimit të qytetit dhe fshatrave të Bashkisë Gramsh. Ai është gjithashtu një thirrje për bashkëpunim dhe angazhim nga të gjitha palët e interesuara — institucionet, prindërit, mësuesit, nxënësit dhe partnerët — për ta kthyer vizionin tonë në realitet.

Me bindjen se investimi në arsim është investim në të ardhmen, Bashkia Gramsh mbetet e përkushtuar të ndërmarrë hapa konkretë për të ndërtuar një mjedis arsimor ku çdo fëmijë të ketë mundësi të barabarta për të mësuar, për t'u rritur dhe për të kontribuar në komunitetin e tij.

Kryetari i Bashkisë Gramsh

Besion Ajazi

Falënderime

Bashkia Gramsh shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar 2026–2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të bashkive të Shqipërisë dhe me ekspertizën teknike të “Smart Processes”, të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik vendor.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë angazhimin e Këshillit Bashkiak të Gramshit, për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë procesit, si dhe për angazhimin e strukturave të tij në sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe transparente.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive dhe sektorëve vendorë të arsimit, financave, infrastrukturës, shërbimeve sociale, si dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, edukatorëve dhe mësuesve që ofruan informacion të vlefshëm dhe reflektim mbi nevojat reale në terren.

Mirënjohje shkon edhe për organizatat e shoqërisë civile, këshillat e prindërve, grupet komunitare dhe partnerët lokalë, të cilët morën pjesë në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e realitetit arsimor dhe prioriteteve të komunitetit.

Ky plan përfaqëson një vullnet të përbashkët për të ndërtuar një sistem arsimor më të mirë për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Gramsh.

1. Hyrje dhe konteksti

Konteksti administrativ

Bashkia Gramsh është një njësi e rëndësishme e qeverisjes vendore në qarkun e Elbasanit, me një territor të gjerë prej 739.22 km² dhe një popullsi prej 25,168 banorësh sipas Censurit 2023 (densiteti 34 banorë/km²). Kryeqendra e saj është qyteti i Gramshit, i shpallur si i tillë në vitin 1960, me një histori të lidhur me agroindustrinë dhe industrinë ushtarake, por edhe me potencial të madh për zhvillimin e turizmit natyror.

Bashkia kufizohet:

- Në veri me bashkinë Elbasan,
- Në lindje me bashkinë Pogradec,
- Në jug-lindje me bashkinë Maliq,
- **Në jug** me bashkinë Skrapar,
- Në perëndim me bashkitë Berat, Kuçovë dhe Cërrik.

Struktura administrative përbëhet nga **10** njësi administrative: Gramsh, Pishaj, Kodovjat, Kukur, Kushovë, Lenie, Poroçan, Skënderbegas, Sult dhe Tunjë, të cilat përfshijnë një qytet dhe 94 fshatra. Ky organizim pasqyron një ndërthurje të zonave urbane dhe rurale, duke ndikuar në mënyrën e shpërndarjes së burimeve njerëzore, infrastrukturore dhe financiare, si dhe në ofrimin e shërbimeve publike, përfshirë arsimin parauniversitar.

Territori i bashkisë është kryesisht malor, me tokë bujqësore që zë rreth 14% të sipërfaqes, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga zona pyjore dhe kullota. Ky profil gjeografik ndikon në sfidat e aksesueshmërisë dhe në nevojën për planifikim të kujdesshëm të shërbimeve arsimore në të gjithë hapësirën territoriale.



Të dhëna kryesore:

- Qendra e bashkisë: Qyteti i Gramshit
- Sipërfaqja: 739.22 km²
- Popullsia: 25,168 banorë
- Dendësia: 34 banorë/km²
- Njësitë administrative: 10 Njësi - Gramsh, Pishaj, Kodovjat, Kukur, Kushovë, Lenie, Poroçan, Skënderbegas, Sult dhe Tunjë
- Fshatra: 94

Të dhëna demografike

Sipas të dhënave më të fundit, Bashkia Gramsh numëron **25,168 banorë**, me një shpërndarje të përafërt gjinore prej **12,898 meshkuj** dhe **12,270 femra**. Popullsia është e shpërndarë në **10 njësi administrative**: Gramsh, Pishaj, Kodovjat, Kukur, Kushovë, Lenie, Poroçan, Skënderbegas, Sult dhe Tunjë.

Shpërndarja e popullsisë sipas gjinisë dhe njësive administrative paraqitet si vijon:


- **Pishaj**: 1,701 meshkuj – 1,640 femra
- **Kodovjat**: 1,479 meshkuj – 1,436 femra
- **Kukur**: 1,430 meshkuj – 1,172 femra
- **Kushovë**: 538 meshkuj – 562 femra
- **Lenie**: 582 meshkuj – 430 femra
- **Poroçan**: 959 meshkuj – 1,006 femra
- **Skënderbegas**: 1,101 meshkuj – 899 femra
- **Sult**: 736 meshkuj – 774 femra
- **Tunjë**: 1,016 meshkuj – 921 femra
- **Gramsh (qendra)**: 3,356 meshkuj – 3,430 femra

Kjo strukturë demografike reflekton një shpërndarje të balancuar gjinore, me dallime të vogla mes numrit të meshkujve dhe femrave në shumicën e njësive. Prania e një përqindjeje të lartë të fëmijëve në moshë parashkollore dhe rinisë e bën të domosdoshme forcimin e rrjetit të shërbimeve arsimore, veçanërisht në arsimin e hershëm dhe atë bazë.

Duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë jeton në zona rurale dhe malore, planifikimi i shërbimeve arsimore duhet të marrë parasysh sfidat e aksesit, transportit dhe sigurimit të kushteve të barabarta për të gjithë fëmijët, pavarësisht vendbanimit.

Struktura e popullsisë së re:

Popullsia e Bashkisë Gramsh ka një shpërndarje të dukshme të moshave të reja, veçanërisht në grupmoshat e fëmijëve në moshë parashkollore dhe shkollore, gjë që e bën arsimin parauniversitar një prioritet të lartë në politikat lokale.



Përmbledhja sipas grupmoshave (e gjithë bashkia):

- **Mosha 3–4 vjeç:** 192 fëmijë
- **Mosha 4–5 vjeç:** 146 fëmijë
- **Mosha 5–6 vjeç:** 226 fëmijë
- **Mosha 6–15 vjeç:** 1,722 fëmijë
- **Mosha 15–18 vjeç:** 532 të rinj

Pjesa më e madhe e popullsisë së re është e përqendruar në qendrën urbane të Gramshit dhe në njësitë administrative Pishaj, Kodovjat dhe Kukur, ku numri i fëmijëve 6–15 vjeç është dukshëm më i lartë.

Njësitë si Kushovë, Lenie, Sult dhe Tunjë kanë popullsi të ulët në moshë parashkollore dhe shkollore, gjë që mund të reflektojë emigrimin, shpërndarjen e ulët të banorëve ose moshën e lartë mesatare të popullsisë.

Kjo shpërndarje nënvizon nevojën për të balancuar investimet midis zonave urbane dhe rurale, duke garantuar akses të barabartë në shërbimet arsimore pavarësisht vendbanimit.

Kuadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor

Zbatimi i funksioneve të Bashkisë Gramsh në fushën e arsimit parauniversitar mbështetet në një kuadër të gjerë kushtetues, ligjor dhe politik, i cili përcakton të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e institucioneve publike për garantimin e të drejtës për arsim.

Bazën më të lartë ligjore e përbën Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ku në nenin 57, pika 1, sanksionohet e drejta për arsim për të gjithë qytetarët. Kjo e drejtë konkretizohet më tej përmes **Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”**, të ndryshuar me **Ligjin nr. 48/2018**, i cili përcakton strukturën dhe funksionimin e arsimit në të gjitha nivelet, duke përfshirë arsimin parashkollor, bazë, të mesëm të përgjithshëm dhe profesional. Ky ligj rregullon gjithashtu standardet e cilësisë, përfshirjes, vlerësimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” u njeh bashkive kompetenca të plota për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e çerdheve dhe kopshteve publike, si dhe role mbështetëse në arsimin bazë dhe të mesëm, përmes sigurimit të infrastrukturës, përfshirjes sociale dhe koordinimit me institucionet qendrore. Këto funksione financohen dhe mbështeten në përputhje me **Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”**, dhe **Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”**, të cilët përcaktojnë rregullat e menaxhimit financiar në nivel vendor. Po ashtu, **Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”**, i ndryshuar, shërben si mjet për mobilizimin e të ardhurave që bashkia mund të përdorë për të mbështetur sektorin e arsimit.

Në nivel zbatimi, funksionimi i institucioneve arsimore rregullohet nga një sërë aktesh nënligjore. Ndër më të rëndësishmet është Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020, që miraton rregulloren e përgjithshme për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, si dhe **Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023**, që përcakton normat për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore për mësuesit. Po ashtu, udhëzimi i përbashkët MAS-MEKI nr. 13, datë 10.07.2024, specifikon organizimin e vitit shkollor 2024–2025, ndërsa Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018, përcakton ngritjen dhe funksionimin e bordeve të institucioneve arsimore, si mekanizma pjesëmarrjeje dhe monitorimi. Një dokument me rëndësi për cilësinë e arsimit parashkollor është edhe Urdhri nr. 199, datë 07.05.2024, që miraton Kornizën e vlerësimit të cilësisë së kopshteve.


Në përputhje me parimet e gjithëpërfshirjes dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, Bashkia Gramsh udhëhiqet gjithashtu nga Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, të cilët kërkojnë ndërhyrje të koordinuara për mbështetjen e fëmijëve në nevojë dhe parandalimin e përjashtimit social. Në këtë drejtim, udhëzime specifike si Udhëzimi nr. 21, datë 08.08.2014, për rritjen e frekuentimit të arsimit nga fëmijët romë, dhe **Plani** Kombëtar i Veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025, përbëjnë udhërrëfyes për politikën lokale në territorin e Bashkisë Gramsh.

Një fushë me rëndësi të veçantë është edhe ofrimi i shërbimit psiko-social në kopshte, i cili rregullohet me Urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, si dhe me udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor, të hartuar për stafet e bashkive dhe të zyrave vendore arsimore. Gjithashtu, për të garantuar një ambient të sigurt dixhital për fëmijët, zbatohet Udhëzimi i përbashkët MAS-MShMS nr. 658, datë 23.09.2019, i cili përcakton masa për mbrojtjen e tyre nga përmbajtjet e dëmshme në internet.

Nëpërmjet këtij kuadri të gjerë ligjor dhe politik, Bashkia Gramsh vepron si një aktor kyç në zbatimin e politikave arsimore dhe sociale, duke siguruar një qasje të koordinuar dhe të ndjeshme ndaj nevojave të fëmijëve dhe familjeve në territorin e saj. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me Zyrën Vendore Arsimore dhe institucionet e tjera publike, synohet ndërtimi i një sistemi arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të qasshëm për të gjithë.


2. Analiza e shërbimit të arsimit PARAUNIVERSITAR në vitin shkollor 2024 – 2025

Shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njësive administrative në Bashkinë Gramsh paraqitet si më poshtë në grafkun ilustrues.



3. Analiza e ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025

Në Bashkinë Gramsh, shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njësive administrative tregon një prani të gjerë të infrastrukturës si për arsimin parashkollor, ashtu edhe për atë bazë dhe të mesëm. Aktualisht, funksionojnë 35 kopshte të vendosura në zona urbane dhe rurale, duke synuar ofrimin e një shërbimi të aksesueshëm për të gjithë fëmijët, pavarësisht vendbanimit. Ky rrjet përbën një përpjekje të dukshme për të siguruar mundësi të barabarta në edukimin e hershëm, jo vetëm në qendrat e banuara urbane, por edhe në zonat e thella rurale.



Frekuentimi

Sipas të dhënave më të fundit të censusit, numri total i fëmijëve të moshës 3–6 vjeç në Bashkinë Gramsh është 540 (288 djem dhe 252 vajza). Nga këta, 325 fëmijë (174 djem dhe 151 vajza) ndjekin institucionet parashkollore, që përfaqëson 60.19% të popullsisë së kësaj grupmoshe.

Nëse krahasojmë me të dhënat e muajit shtator 2024, përfshirja e fëmijëve në kopshte ishte shumë e lartë 97.77% ku vetëm 12 fëmijë ishin të paregjistruar. Ndryshimet ndërmjet periudhave tregojnë nevojën për politika të qëndrueshme dhe monitorim të vazhdueshëm për të ruajtur nivelet e larta të përfshirjes.

Sipas të dhënave të qershorit 2025, numri i fëmijëve që ndjekin kopshtin ka rënë në **459** (232 djem dhe 227 vajza), çka sinjalizon se faktorë si migrimi, kushtet socio-ekonomike dhe ndërgjegjësimi prindëror mund të kenë ndikuar në pjesëmarrje.

Përsa i përket dallimeve gjinore, përqindja e përfshirjes është e ngjashme: 60.42% për djemtë dhe 59.92% për vajzat. Ky balancim tregon se diferencat gjinore nuk janë faktori kryesor i mospjesëmarrjes, por ndërhyrjet duhet të fokusohen në:

- Zgjerimin e aksesit fizik për zonat e largëta;
- Përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve;
- Rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve mbi rëndësinë e edukimit të hershëm.

Shërbimi psiko-social në arsimin parashkollor


Në institucionet parashkollore të Bashkisë Gramsh, mbështetja psikosociale ofrohet nga një psikolog i dedikuar, i cili punon në bashkëpunim të ngushtë me edukatorët dhe prindërit për të vlerësuar dhe adresuar nevojat e fëmijëve. Përfshirja sociale inkurajohet dhe mbështetet edhe nga pranimi i 6 fëmijëve me aftësi ndryshe, duke krijuar një mjedis gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë.

Për rastet që kërkojnë ndërhyrje të specializuara, kopshtet bashkëpunojnë me Sektorin e Shërbimeve Sociale të Bashkisë Gramsh, duke siguruar qasje të koordinuar në mbështetje dhe shërbime.

4. Analiza e shërbimit në shkollat e arsimit bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2024 – 2025

Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit

Në të gjithë territorin e bashkisë janë të shpërndara gjithsej 47 institucione arsimore të niveleve të ndryshme, të cilat mbulojnë të gjitha njësitë administrative. Ky organizim krijon një rrjet të larmishëm dhe funksional të arsimit parauniversitar, që shtrihet në të gjithë territorin, duke reflektuar vullnetin institucional duke synuar mbulimin sa më të plotë të nevojave arsimore të komunitetit në të gjitha njësitë administrative.



Ky rrjet arsimor përfshin institucione të niveleve të ndryshme, të strukturuar sipas ciklit të edukimit që ofrojnë:

- **Shkolla fillore – 14 gjithsej**

Këto institucione u shërbejnë fëmijëve në fazat e para të edukimit, duke ofruar bazat e leximit, shkrimit, matematikës dhe lëndëve të tjera themelore. Vendndodhja e tyre është zgjedhur në mënyrë që të jenë sa më pranë vendbanimeve, duke lehtësuar aksesin për nxënësit e vegjël dhe duke reduktuar nevojën për udhëtime të gjata.

- **Shkolla 9-vjeçare – 25 gjithsej**

Ky nivel përfshin si ciklin fillor, ashtu edhe atë të mesëm të ulët, duke ofruar një arsim bazë të plotë dhe të strukturuar. Shkollat 9-vjeçare janë thelbësore për zhvillimin akademik, shoqëror dhe kulturor të nxënësve, si dhe për përgatitjen e tyre për nivelin e mesëm.

- **Shkolla të mesme – 8 gjithsej**

Të përfshira këtu janë gjimnazet të cilat synojnë të pajisin nxënësit me njohuri të thelluara për studime universitare ose aftësi praktike për tregun e punës. Vendosja e tyre në zona qendrore dhe strategjike u mundëson të rinjve nga zona të ndryshme të bashkisë të përfitojnë nga ky nivel arsimimi.

- **Konvikti i nxënësve në Gramsh** frekuentohet nga rreth 26 fëmijë, të cilët e përdorin si vendbanim gjatë periudhës së shkollimit, duke u mundësuar akses në arsim pavarësisht distancës nga vendbanimi i tyre familjar.
- **Qendra Kulturore e Fëmijëve “Adem Hoxha”** frekuentohet nga rreth 180 fëmijë, të cilët marrin pjesë rregullisht në aktivitete artistike, kulturore dhe edukative. Programet përfshijnë kurse të muzikës, vallëzimit, arteve pamore, recitimit dhe veprimtari të tjera krijuese, duke nxitur talentet dhe aftësitë shprehëse të fëmijëve, si dhe pjesëmarrjen e tyre në konkurse e

Në tërësi, rrjeti arsimor i Bashkisë Gramsh është projektuar për të siguruar **akses të barabartë dhe cilësi të njëtrajtshme** të arsimit për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, duke marrë parasysh shpërndarjen gjeografike, densitetin e popullsisë dhe nevojat specifike të komuniteteve urbane dhe rurale.

Frekuentimi sipas niveleve arsimore

Arsimi fillor

Në arsimin fillor janë të regjistruar gjithsej 866, nga të cilët 469 janë djem dhe 397 vajza. Sipas të dhënave të raportuara, 54.16% e tyre janë djem dhe 45.84% vajza. Kjo ndarje reflekton situatën e përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi, në varësi të kushteve lokale, demografisë, dhe mundësive të ofruara në komunitet. Të dhënat nënvizojnë rëndësinë e vazhdimet të përpjekjeve për të

Gjinia	Numri i Nxënësve në arsimin fillor	Përqindja (%)
Djem	469	54.16
Vajza	397	45.84

garantuar akses të barabartë dhe gjithëpërfshirës në arsimin fillor për të gjithë fëmijët, pavarësisht vendbanimit apo karakteristikave të tjera sociale. Sigurimi i kushteve të përshtatshme për ndjekjen e shkollës dhe mbështetja institucionale mbeten faktorë kyç për përmirësimin e mëtejshëm të përfshirjes.

Arsimi 9-vjeçar

Në institucionet 9-vjeçare të Bashkisë Gramsh janë të regjistruar gjithsej 732 nxënës, prej të cilëve 352 janë djem dhe 380 janë vajza. Shpërndarja gjinore tregon se 48.09% e nxënësve janë djem dhe 51.91% janë vajza, duke reflektuar një përfshirje të balancuar, me një prani disi më të lartë të vajzave.

Gjinia	Numri i Nxënësve në arsimin 9-vjeçar	Përqindja (%)
Djem	352	48.09
Vajza	380	51.91

Ky raport ndryshon nga një njësi administrative në tjetrën, i ndikuar nga faktorë lokalë si vendndodhja e shkollave, infrastruktura e transportit, kushtet socio-ekonomike dhe lëvizjet demografike. Pavarësisht këtyre variacioneve, të dhënat nënvizojnë rëndësinë e monitorimit të rregullt të pjesëmarrjes në arsim, për të identifikuar në kohë tendencat ose boshllëqet që mund të ndikojnë në vazhdimësinë e shkollimit.

Arsimi i mesëm

Gjinia	Numri i Nxënësve në arsimin e mesëm	Përqindja (%)
Djem	306	48.96
Vajza	319	51.04

Në institucionet e arsimit të mesëm të Bashkisë Gramsh janë të regjistruar gjithsej 625 nxënës, prej të cilëve 306 janë djem dhe 319 janë vajza. Kjo përfaqëson një ndarje gjinore prej 48.96% djem dhe 51.04% vajza, duke treguar një përfshirje të balancuar mes gjinive, me një prani disi më të lartë të vajzave.

Shpërndarja e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm ndikohet nga një sërë faktorësh, përfshirë zgjedhjet individuale të nxënësve për të ndjekur shkolla të përgjithshme apo profesionale, si dhe faktorë socialë, ekonomikë dhe kulturorë që mund të ndryshojnë nga një zonë në tjetrën.

Ky nivel arsimor është thelbësor për zhvillimin personal të të rinjve, prandaj kërkohet mbështetje e vazhdueshme dhe politika gjithëpërfshirëse që nxisin vijimin e shkollimit për të gjithë. Kjo përfshin sigurimin e kushteve të përshtatshme të mësimdhënies, orientimin profesional, ofrimin e mundësive të barabarta për të dy gjinitë dhe lehtësimin e aksesit në shkolla, veçanërisht për nxënësit nga zonat rurale dhe të largëta.

5. Shërbimi i Arsimit sipas njësive administrative

Njësia Administrative Pishaj

Pishaj përmban një rrjet të gjerë institucionesh arsimore me gjithsej 11 shkolla – 4 fillore, 6 nëntëvjeçare dhe 1 të mesme – të shpërndara në mënyrë që të mbulojnë si vendbanimet qendrore ashtu edhe ato rurale.

Shkollat:

- “Jonuz Çarçiu” (Gjergjovië),
- “Tahir Balliu” (Çekin),
- “4-Dëshmorët” (Drizë),
- “Këshilltarët e Galigatit” (Galigat),
- “Estref Bajrami” (Tërvol),
- “Hasan Dermyshe” (Gramsh-Fshat),
- “18 Gushti” (Shëmrizë),
- Gurrëz,
- Ostenth,
- Vinë,
- Storr

Kopshtet: 11 gjithsej, të vendosura në Çekin, Gramsh-Fshat, Tërvol, Gjergjovinë, Drizë, Kotorr, Cërurë, Shëmrizë, Gurrëz, Ostenth, Trashovicë.

Njësia Administrative Kodovjat

Në Kodovjat funksionojnë **5 shkolla – 1 fillore, 3 nëntëvjeçare dhe 1 e mesme** – duke garantuar mbulim arsimor për komunitetin lokal dhe fshatrat përreth.

Shkollat:

- “Afëz Berbiu” (Kodovjat),
- “Zeqo Dermyshe” (Mashan),
- “Qani Musai” (Kishtë),
- “Dervish Muha” (Bërsnik),
- Bulçar.

Kopshtet: 4 gjithsej, në Mashan, Kodovjat, Bulçar, Bërsnik.

Njësia Administrative Kukur

Kukur disponon **6 shkolla – 1 fillore, 4 nëntëvjeçare dhe 1 e mesme** – të pozicionuara në pika kyçe për të siguruar akses për nxënësit e zonës.

Shkollat:

- “Muharrem Zela” (Kukur),
- “Kadri Veliu” (Gribë),
- “Reshit Hoxha” (Grazhdan),
- “Shaqir Baushi” (Snosëm),
- “Afëz Guzi” (Sojnik),
- Rmath.

Kopshtet: 6 gjithsej, në Kukur, Gribë, Veliaj, Rmath, Snosëm.

Njësia Administrative Kushovë

Kushova ka **4 shkolla – 2 fillore dhe 2 nëntëvjeçare** – dhe nxënësit e arsimit të mesëm ndjekin shkollat në Gramsh ose qytete të tjera.

Shkollat:

- “Sabri Daja” (Kushovë),
- “Nazif Zhupani” (Sotirë),
- Kërpicë,
- Dumberas.

Kopshtet: 2 gjithsej, në Kushovë dhe Sotirë.

Njësia Administrative Lenie

Lenie ka **2 shkolla – 1 nëntëvjeçare dhe 1 të mesme** – që mbulojnë arsimin bazë dhe atë të lartë për zonën.

Shkollat:

- “Tahir Sadiku”, (Lenie),
- “Koli Baba” Grabovë.

Kopshtet: 2 gjithsej, në Lenie dhe Grabovë.

Njësia Administrative Poroçan

Poroçani ka **4 shkolla** – **2 fillore**, **1 nëntëvjeçare** dhe **1 e mesme** – duke ofruar arsim nga cikli i ulët deri në atë të mesëm.

Shkollat:

- “Skënder Buzdra”, (Poroçan),
- Lleshan,
- “Maksut Roshi” (Holtas),
- Kabash.

Kopshtet: 1 në qendrën e Poroçanit.

Njësia Administrative Skënderbegas

Skënderbegasi ka **5 shkolla** – **3 fillore**, **1 nëntëvjeçare** dhe **1 të mesme** – duke mbuluar një territor me disa fshatra të shpërndarë.

Shkollat:

- “Xhile Liçi” (Skënderbegas),
- “Vesel Hova” (Vidhan),
- Fushëz,
- Siman,
- Nartë.

Kopshtet: 4 gjithsej, në Skënderbegas, Harunas, Nartë.

Njësia Administrative Sult

Sulti ka **3 shkolla** – **1 fillore** dhe **2 nëntëvjeçare** – ndërsa nxënësit e arsimit të mesëm ndjekin shkollat në Gramsh ose qytete të tjera.

Shkollat:

- “Dervish Miraka”,
- Kukucovë,
- Mazrekë.

Kopshtet: 1, në Sult.

Njësia Administrative Tunjë

Tunjë ka **3 shkolla** – **2 nëntëvjeçare** dhe **1 të mesme** – të cilat mbulojnë arsimin bazë dhe të lartë për komunitetin.

Shkollat:

- “Çaush Senia”
- “Sabri Salla”
- “Mestan Toska”

Kopshtet: 1 gjithsej, në Tunjë.

Njësia Administrative Gramsh (Qendra)

Qendra e bashkisë ka **4 shkolla** – **3 nëntëvjeçare** dhe **1 të mesme** – duke shërbyer si një pol kryesor arsimor për të gjithë territorin.

Shkollat:

- “35 Vjetori i Çlirimit”
- “Rilindja”
- “Asllan Shahini”
- “Shefqet Guzi”

Kopshtet: 3 gjithsej, Kopshti Nr.1, Kopshti Nr.2, Kopshti Nr.3. Një kopsht në qytetin e Gramshit ofron shërbim ushqimi me drekë për 92 fëmijë.

6. Burimet njerëzore në Arsimin Parauniversitar dhe shërbimet mbështetëse

Rrjeti arsimor dhe institucionet mbështetëse në Bashkinë Gramsh funksionojnë falë një strukture të gjerë burimesh njerëzore, të shpërndara në arsimin parashkollor, shkolla, konvikt dhe Qendrën Kulturore të Fëmijëve.

Në arsimin parashkollor janë të angazhuara gjithsej **62 edukatore**, përfshirë 3 drejtoresha dhe 6 mësuese ndihmëse, të mbështetura nga një psikologe e dedikuar për të gjitha kopshtet. Për mirëmbajtjen dhe funksionimin e tyre punojnë gjithashtu **4 sanitare**, **2 kuzhinierë** dhe **1 magazinier** për çerdhen dhe kopshtet dhe institucionet e arsimit.

Në shkolla, shërbimet mbështetëse sigurohen nga një sekretare në shkollën e mesme, 4 roje dhe 19 pastruese që mbulojnë plotësisht pastrimin dhe higjienën e të gjitha shkollave në qytet dhe fshatra.

Konvikti i nxënësve në Gramsh akomodon rreth 25 fëmijë, me një staf prej 2 përgjegjësish/kujdestarësh, 2 punonjësish kuzhine, 3 lavanderësh dhe sanitareve, si dhe 1 roje, duke garantuar kushte të sigurta dhe të përshtatshme për jetesë dhe mësim.

Qendra Kulturore e Fëmijëve “Adem Hoxha” është një hapësirë e rëndësishme zhvillimi kulturor.. Stafi përbëhet nga 8 punonjës: 1 drejtor, 2 përgjegjës sektori, 4 instruktorë/specialistë dhe 1 sanitare, të cilët organizojnë aktivitete artistike, kulturore dhe edukative gjatë gjithë vitit.

Ky strukturim i burimeve njerëzore garanton që institucionet arsimore dhe ato mbështetëse të ofrojnë një mjedis të sigurt, funksional dhe të përshtatshëm për mësim, zhvillim personal dhe socializim të fëmijëve dhe të rinjve në territorin e Bashkisë Gramsh.

7. Vizioni, Qëllimet Strategjike, Objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar



Vizioni

Bashkia Gramsh synon një sistem arsimor parauniversitar cilësor, modern dhe gjithëpërfshirës, që u garanton të gjithë fëmijëve e nxënësve kushte optimale për të mësuar, për t'u rritur dhe për t'u zhvilluar në bashkëpunim me familjen dhe komunitetin.

Duke marrë në konsideratë analizat e deritanishme mbi shpërndarjen gjeografike të institucioneve arsimore, kapacitetet e burimeve njerëzore, boshllëqet në infrastrukturë dhe nivelin e pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim, Bashkia Gramsh angazhohet të ndjekë këto qëllime dhe objektiva strategjike:

Qëllimi (Q1). Të garantohet funksionimi i qëndrueshëm, cilësor dhe gjithëpërfshirës i institucioneve të arsimit parauniversitar (parashkollor, bazë dhe i mesëm i përgjithshëm) në territorin e bashkisë, duke siguruar kushte optimale për mësimdhënie, mirëqenie dhe zhvillim të fëmijëve dhe nxënësve.

- **Objektivi 1.1** Të sigurohet mbulimi i plotë me staf arsimor dhe staf të shërbimeve mbështetëse, si dhe ofrimi i infrastrukturës së përshtatshme, kushteve higjieno-sanitare, sistemeve të ngrohjes dhe furnizimeve të nevojshme për të gjitha institucionet arsimore në kuadër të garantimit të cilësisë dhe vazhdimësisë së shërbimit.
- **Objektivi 1.2** Deri në fund të vitit 2028, të realizohet rikonstruksioni i të paktën një institucioni arsimor 9-vjeçar, të sigurohet pajisja e institucioneve parashkollore me pajisje informatike dhe mjete të tjera didaktike, si dhe të krijohet dhe të përdoret një regjistër digjital i integruar e i përditësuar për kopshtet dhe shkollat, me synim përmirësimin e kushteve të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së arsimit, garantimin e aksesit të barabartë për fëmijët dhe rritjen e eficiencës në menaxhim e planifikim afatgjatë të investimeve.

Qëllimi (Q2) Të garantohet ofrimi i një edukimi parashkollor cilësor dhe gjithëpërfshirës, i bazuar në standarde bashkëkohore të mësimdhënies dhe mbështetjes zhvillimore, përmes fuqizimit të kapaciteteve të stafit edukativ e mbështetës, përdorimit të metodologjive inovative

dhe nxitjes së shkëmbimit të praktikave të mira, duke siguruar që çdo fëmijë të ketë mundësi të barabarta për të mësuar, për t'u rritur dhe për t'u zhvilluar.

- **Objektivi 2.1** Të rritet cilësia e edukimit parashkollor nëpërmjet forcimit të kapaciteteve profesionale të edukatorëve dhe stafit mbështetës, duke promovuar mësimdhënien e orientuar drejt fëmijës, përdorimin e metodologjive bashkëkohore dhe mjeteve didaktike inovative, si dhe shkëmbimin e praktikave të mira për zhvillimin gjithëpërfshirës të fëmijëve.
- **Objektivi 2.2** Të sigurohet mbështetje gjithëpërfshirëse për fëmijët dhe nxënësit në institucionet arsimore përmes angazhimit të mësuesve ndihmës, forcimit të strukturave pjesëmarrëse dhe këshilluese, ofrimit të shërbimeve psiko-sociale, si dhe mbështetjes së fëmijëve nga familjet në nevojë dhe atyre me rezultate të shkëlqyera, duke garantuar akses të barabartë, përfshirje aktive dhe zhvillim të plotë në procesin arsimor.

Qëllimi (Q3) Të zhvillohen dhe të institucionalizohen aktivitete të rregullta kulturore, sportive, mjedisore dhe ndërgjegjësuere në të gjitha institucionet arsimore, me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve dhe mbështetjen e stafit pedagogjik, prindërve dhe komunitetit, me qëllim nxitjen e zhvillimit të përgjithshëm, forcimin e bashkëpunimit shkollë–familje–komunitet dhe promovimin e vlerave të diversitetit, solidaritetit dhe përfshirjes sociale.

- **Objektivi 3.1** Të organizohen rregullisht aktivitete kulturore, sportive dhe ndërgjegjësuere (si ditë tematike, ekspozita, aktivitete mjedisore dhe komunitare), me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve dhe mbështetjen e institucioneve arsimore, Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Adem Hoxha” dhe komunitetit, për të nxitur zhvillimin e përgjithshëm dhe integrimin social të tyre.

8. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar

Arsimi bazë përfshi arsimin parashkollor

Plani financiar i parashikuar për periudhën 2025–2028 për arsimin bazë, duke përfshirë arsimin parashkollor, reflekton angazhimin e Bashkisë për të garantuar funksionimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit arsimor në territorin e saj.

Në vitin 2025, buxheti total i planifikuar arrin në 180,975 mijë lekë, ku pjesën më të madhe e zënë pagat, shpërblimet dhe shpenzimet e tjera të personelit (95,922 mijë lekë), ndjekur nga **shpenzimet** për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (47,468 mijë lekë), mallrat dhe shërbimet e tjera (22,567 mijë lekë) dhe kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore (15,018 mijë lekë).

Në vitin 2026, buxheti planifikohet të rritet ndjeshëm në 219,657 mijë lekë, kryesisht si rezultat i rritjes së fondeve për investime në infrastrukturë dhe pajisje (93,460 mijë lekë për rritjen e aktiveve të qëndrueshme). Në vitin 2027, planifikimi është 178,480 mijë lekë, ndërsa në vitin 2028 planifikohet në 145,451 mijë lekë.

Këto shifra tregojnë një fokus të fortë në mbulimin e shpenzimeve të personelit dhe mirëmbajtjen e funksionalitetit të institucioneve arsimore, krahas një cikli investimesh më të larta në vitin 2026 për të përmirësuar infrastrukturën dhe bazën materiale të arsimit bazë e parashkollor. Plani financon jo vetëm nevojat operacionale, por edhe zhvillimin afatgjatë, duke krijuar bazën për një shërbim arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës.

Aktivitete	Viti 2025 në lekë	Viti 2026 në lekë	Viti 2027 në lekë	Viti 2028 në lekë
Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	95,922	89,923	89,923	89,923
Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	15,018	15,017	15,017	15,017
Mallra dhe sherbime te tjera	22,567	21,257	21,800	22,511
Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	47,468	93,460	51,740	18,000
Totali	180,975	219,657	178,480	145,451

Arsimi i mesëm i përgjithshëm

Plani financiar për arsimin e mesëm të përgjithshëm për periudhën 2025–2028 paraqet një buxhet më të kufizuar krahasuar me arsimin bazë dhe parashkollor, por të strukturuar për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm të këtij niveli arsimor.

Në vitin 2025, fondet e planifikuara arrijnë 18,050 mijë lekë, ku pjesën më të madhe e zënë pagat, shpërblimet dhe shpenzimet e tjera të personelit (8,849 mijë lekë) dhe mallrat e shërbimet e tjera (7,806 mijë lekë). Kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore llogariten në 1,395 mijë lekë.

Gjatë vitit 2026, buxheti bie në 12,244 mijë lekë, me një ulje të dukshme të fondeve për mallrat dhe shërbimet e tjera (nga 7,806 mijë lekë në 2,500 mijë lekë), ndërkohë që shpenzimet për personelin dhe kontributet mbeten të qëndrueshme. Në vitin 2027, plani parashikon 12,344 mijë lekë, me një rritje të lehtë të mallrave e shërbimeve (2,600 mijë lekë), ndërsa në vitin 2028 buxheti shkon në 12,844 mijë lekë.

Fokusi më i madh do të jetë shpenzimet operative dhe mirëmbajtja bazë e funksionimit të shkollave të mesme. Ky plan financiar synon të ruajë vazhdimësinë e shërbimit arsimor, duke siguruar pagesat e personelit dhe furnizimet e nevojshme, duke lënë hapësirë për të rritur mundësitë e investimeve në infrastrukturë dhe pajisje.

Llogaria	Viti 2025 në lekë	Viti 2026 në lekë	Viti 2027 në lekë	Viti 2028 në lekë
Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	8,849	8,350	8,350	8,350
Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	1,395	1,394	1,394	1,394
Mallra dhe sherbime te tjera	7,806	2,500	2,600	3,100
Totali	18,050	12,244	12,344	12,844

9. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)

Qëllimi 1 (Q1) – Të garantohet funksionimi i qëndrueshëm, cilësor dhe gjithëpërfshirës i institucioneve të arsimit parauniversitar (parashkollor, bazë dhe i mesëm i përgjithshëm) në territorin e bashkisë, duke siguruar kushte optimale për mësimdhënie, mirëqenie dhe zhvillim të fëmijëve dhe nxënësve.

Objektivi specifik O1.1 Të sigurohet mbulimi i plotë me staf arsimor dhe staf të shërbimeve mbështetëse, si dhe ofrimi i infrastrukturës, kushteve higjieno-sanitare, sistemeve të ngrohjes dhe furnizimeve të nevojshme për të gjitha institucionet arsimore në kuadër të garantimit të cilësisë dhe vazhdimësisë së shërbimit.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Treguesit e matjes së progresit
Sigurimi i stafit të nevojshëm arsimor dhe të punonjësve të shërbimeve mbështetëse për arsimin parashkollor, bazë dhe të mesëm <i>Ky aktivitet ka për qëllim të garantojë plotësimin e nevojave për personel mësimor dhe ndihmës në të gjitha institucionet arsimore, duke përfshirë:</i> Stafi mësimor Arsimi parashkollor: 62 edukatore (përfshirë 3 drejtoresha) + 6 mësuese ndihmëse Totali stafi mësimor = 68 persona	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Këshilli Bashkiak	Transferte specifike + Buxhet vendor	<i>Numri i kopshteve të mbështetura me staf edukativ dhe mbështetës;</i> <i>Numri i personelit edukativ në arsimin parashkollor;</i> <i>Numri i stafit për shërbimet mbështetëse në institucionet arsimore parashkollore (roje, pastrues, ndihmës teknikë, etj.);</i> <i>Raporti i mësuesve ndihmës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshte;</i> <i>Numri i fëmijëve të regjistruar në kopshte</i> <i>Numri i fëmijëve egjiptianë të regjistruar në kopshte;</i> <i>Ndryshimi vit pas viti në % i numrit të fëmijëve egjiptian të regjistruar në koshte;</i> <i>Numri i fëmijëve të regjistruar në shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm;</i> <i>Numri i fëmijëve rom dhe egjiptianë të regjistruar në shkolla;</i>

Stafi mbështetës - Arsimi parashkollor: 1 psikologe + 4 sanitare + 2 kuzhinierë + 1 magazinier = 8 Shkollat: 1 sekretare + 4 roje + 18 pastruese = 23 - Konvikti: 2 përgjegjës/kujdestarë + 2 punonjës kuzhine + 3 lavander/sanitare + 1 roje = 8 - Qendra Kulturore e Fëmijëve “Adem Hoxha”: 1 drejtor + 2 përgjegjës sektori + 4 instruktorë/specialistë + 1 sanitare = 8 Totali stafi mbështetës = 47 personel					Ndryshimi vit pas viti në % i numrit të fëmijëve egjyptian të regjistruar; (që frekuentojnë) në shkolla; Raporti edukator për fëmijë në kopsht; Numri mesatar i fëmijëve për grup; Numri mesatar i fëmijëve për grup në parashkollor (klasa përgatitore); Numri i shkollave të mbështetura me staf mbështetës; Numri i stafit mbështetës në institucionet arsimore shkollore (roje, pastrues; ndihmës teknikë, etj.); Numri mesatar i nxënësve për klasë në arsimin bazë; Numri mesatar i nxënësve për klasë në arsimin e mesëm; Shpenzime për shërbime mbështetëse për nxënës (në mijë lekë);
Mirëmbajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës arsimore <i>Për të siguruar kushte të përshtatshme mësimi dhe zhvillimi për fëmijët dhe nxënësit, do të realizohen ndërhyrje për riparime, rikonstruksione të pjesshme dhe investime të tjera të vogla infrastrukturore. Këto ndërhyrje do të fokusohen në përmirësimin e</i>	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet;	Shkollat, kopshtet	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar	Numri godinave të arsimit (parashkollor, 9- vjeçar, i mesëm) ku janë bërë ndërhyrje të mirëmbajtjes;

<i>godinave ekzistuese, ambienteve të brendshme, sistemeve të ndriçimit dhe mobilimit, duke përfshirë 35 kopshte dhe 47 shkolla.</i>					
Sigurimi i furnizimit dhe shërbimit me ujë të pijshëm dhe energji elektrike për të gjitha institucionet arsimore	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Operatorë të energjisë,	Buxhet vendor + transfertë specifike	Nr. i institucioneve arsimore parashkollre, te arsimit bazë dhe atij të mesëm me furnizim të rregullt me ujë të pijshëm; Nr. i institucioneve arsimore parashkollre, te arsimit bazë dhe atij të mesëm me furnizim të rregullt me energji elektrike;
Garantimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve higjieno-sanitare <i>Do të sigurohen materiale dhe pajisje për mirëmbajtjen e higjienës, si dhe shërbime pastrimi të rregullta për të gjitha institucionet arsimore. Aktiviteti synon të mbajë ambientet e kopshteve dhe shkollave të pastra dhe të sigurta për shëndetin e fëmijëve dhe stafit. Ky aktivitet përfshin 35 kopshte dhe 47 shkolla..</i>	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Shkollat, operatorë të higjienës, kopshtet	Buxhet vendor, transfertë e pakushtëzuar	Nr. i shkollave me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare Nr. i kopshteve me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare
Sigurimi i sistemit të ngrohjes funksional për të gjitha institucionet arsimore <i>Kjo përfshin mirëmbajtjen e infrastrukturës së ngrohjes, dhe sigurimin e karburantit apo burimeve të tjera energjie për funksionimin e tyre. Aktiviteti</i>	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Operatorë të energjisë,	Buxhet vendor + transfertë specifike	Nr. i institucioneve arsimore parashkollre, te arsimit bazë dhe atij të mesëm me sistem të sigurtë dhe funksional ngrohjeje

<i>mbulon , duke përfshirë 35 kopshte dhe 47 shkolla.</i>					
Furnizimi me kancelari për institucionet arsimore <i>Për të mundësuar zhvillimin normal të procesit mësimor dhe administrativ, do të sigurohen furnizime të vazhdueshme me materialet e nevojshme kancelarike, duke përfshirë 35 kopshte dhe 47 shkolla.</i>	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Shkollat	Buxhet vendor	Nr. i institucioneve të furnizuara me kancelari
Furnizimi, kontrolli dhe kolaudimi i fikseve të zjarrit <i>Do të realizohet furnizimi dhe instalimi i fikseve të zjarrit në të gjitha institucionet arsimore, si dhe kontrolli periodik i funksionalitetit të tyre dhe kolaudimi sipas standardeve të sigurisë. Ky aktivitet përfshin 35 kopshte dhe 47 shkolla.</i>	2026–2028	Zyra e Emergjencave	Zjarrfikësja, NjA	Buxhet vendor	Nr. i fikseve të vendosura dhe funksionale; Nr. i kopshteve dhe shkollave me fikse zjarri funksionale;
Furnizimi me dokumentacion administrativ për institucionet arsimore <i>Do të sigurohet dokumentacioni i nevojshëm për administrimin dhe menaxhimin e shkollave dhe kopshteve, si regjistra, fletëvlerësime, dosje dhe dokumente të tjera zyrtare, për 35 kopshte dhe 47 shkolla.</i>	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	Shkollat	Buxhet vendor	Nr. i shkollave të pajisura me dokumentacion

Furnizimi dhe shërbimi ushqimor në institucionet e arsimit parashkollor <i>Ky aktivitet përfshin sigurimin e ushqimit të shëndetshëm dhe të balancuar për fëmijët e një kopshti në Gramsh, duke garantuar standardet ushqimore dhe higjienike.</i>	2026–2028	Zyra Shëndetit Publik & Arsimit	Operatorët e licencuar, Ministria e Arsimit, Sportit (MAS)	Buxhet vendor	Nr. i kopshteve me ushqim; Nr. i fëmijë që përfitojn nga shërbimi i vakteve ushqimore në kopsht;
Kryerja e shërbimit të dezinfektimit në institucionet arsimore Për të parandaluar përhapjen e infeksioneve dhe për të garantuar një ambient të shëndetshëm, do të kryhen dezinfektime periodike në të gjitha institucionet e arsimit parashkollor, bazë dhe të mesëm. Ky aktivitet përfshin 35 kopshte dhe 47 shkolla.	2026–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike	Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), operatorë të kontraktuar	Buxhet vendor + fond emergjence	Nr. i kopshteve dhe shkollave për të cilat krhet shërbimi i dezinfektimit;

Objektivi specifik O1.2 Deri në fund të vitit 2028, të realizohet rikonstruksioni i të paktën një institucioni arsimor 9-vjeçar, të sigurohet pajisja e institucioneve parashkollore me pajisje informatike dhe mjete të tjera didaktike, si dhe të krijohet dhe të përdoret një regjistër digjital i integruar e i përditësuar për kopshtet dhe shkollat, me synim përmirësimin e kushteve të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së arsimit, garantimin e aksesit të barabartë për fëmijët dhe rritjen e eficiencës në menaxhim e planifikim afatgjatë të investimeve.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Treguesit e matjes së progresit
Rikonstruksioni i Shkollës 9-vjeçare “35 Vjetori i Çlirimit” – 88,460 (2026) + 46,740 (2027) = 135,200	2026 - 2027	Njësia përgjegjese për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Qeveria shqiptare Bashkia, donatorë	Buxheti i Bashkisë, transferime nga qeveria qendrore	Nr. i institucioneve arsimore të rikonstruktura; përmirësim i kushteve
Blerje pajisje informatike dhe pajisje të tjera shkollore për arsimin parashkollor – 5,000 (2026) + 5,000 (2027) + 18,000 (2028) = 28,000	2026–2027–2028	Njësia përgjegjese për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Kopshtet/shkol lat; Ekspertë të jashtëm për mbështetje	Buxheti i Bashkisë (orë pune punonjës të angazhuar në punë),	Numri i pajisjeve informatike dhe pajisjeve të tjera shkollore për arsimin parashkollor të blera; Numri i institucioneve arsimore të pajisura me pajisje të reja informatike; Numri i kopshteve të pajisura me pajisje të tjera shkollore për arsimin parashkollor;
Zhvillimi dhe ndërtimi i një regjistri të dhënash digjital për institucionet arsimore <i>Krijimi i një regjistri të centralizuar elektronik që mbledh, ruan të dhënat për kopshtet dhe shkollat, duke mundur menaxhim më efikas të informacionit mbi infrastrukturën, stafin, numrin e fëmijëve/nxënësve, nevojat për investime dhe shërbimet mbështetëse.</i>	2026–2028	Njësia përgjegjese për arsimin, Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet	Kopshtet/shkol lat; Ekspertë të jashtëm për mbështetje	Buxheti i Bashkisë (orë pune punonjës të angazhuar në punë),	Një regjistër i shërbimit për arsimin parashkollor, arsimin baze dhe atë të mesëm i krijuar, dhe i përditësuar çdo vit me të dhëna

Qëllimi 2 (Q2) – Të garantohet ofrimi i një edukimi parashkollor cilësor dhe gjithëpërfshirës, i bazuar në standarde bashkëkohore të mësimdhënies dhe mbështetjes zhvillimore, përmes fuqizimit të kapaciteteve të stafit edukativ e mbështetës, përdorimit të metodologjive inovative dhe nxitjes së shkëmbimit të praktikave të mira, duke siguruar që çdo fëmijë të ketë mundësi të barabarta për të mësuar, për t’u rritur dhe për t’u zhvilluar.

Objektivi specifik O2.1 Të rritet cilësia e edukimit parashkollor nëpërmjet forcimit të kapaciteteve profesionale të edukatorëve dhe stafit mbështetës, duke promovuar mësimdhënien e orientuar drejt fëmijës, përdorimin e metodologjive bashkëkohore dhe mjeteve didaktike inovative, si dhe shkëmbimin e praktikave të mira për zhvillimin gjithëpërfshirës të fëmijëve.

Aktivitetet	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Treguesit e matjes së progresit
Zhvillimi i një programi të vazhdueshëm trajnimi për edukatorët dhe stafin mbështetës të institucioneve parashkollore, me fokus në përdorimin e metodologjive bashkëkohore dhe mjeteve didaktike inovative. Aktiviteti do të përfshijë: <i>Organizimin e sesioneve praktike dhe workshopeve mbi mësimdhënien e orientuar drejt fëmijës;</i> <i>Përdorimin e materialeve moderne edukative për të nxitur kreativitetin, zhvillimin social dhe emocional të fëmijëve;</i> <i>Forcimin e aftësive për vlerësimin e ecurisë individuale të fëmijës dhe përshtatjen e programeve sipas nevojave të tij;</i> <i>Shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira ndërmjet institucioneve brenda dhe jashtë bashkisë.</i>	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin,	MAS, institucionet arsimore, OSHC, ASCAP	Buxhet vendor, projekte me financim të huaj	Nr. i edukatorëve të trajnuara; Nr. i kopshteve/fëmijëve që kanë përfituar nga praktika të përmirësuara të mësimdhënies;

Objektivi specifik O2.2 Të sigurohet mbështetje gjithëpërfshirëse për fëmijët dhe nxënësit në institucionet arsimore përmes angazhimit të mësuesve ndihmës, forcimit të strukturave pjesëmarrëse dhe këshilluese, ofrimit të shërbimeve psiko-sociale, si dhe mbështetjes së fëmijëve nga familjet në nevojë dhe atyre me rezultate të shkëlqyera, duke garantuar akses të barabartë, përfshirje aktive dhe zhvillim të plotë në procesin arsimor.

Aktivitetet	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Treguesit e matjes së progresit
Angazhimi i mësuesve ndihmës në kopshte <i>Mbështetja me mësues ndihmës në institucionet parashkollore për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata që kanë nevojë të veçanta në procesin e edukimit.</i>	2025–2028	Njësia për Arsimin	MASR, Drejtoritë e arsimit, OSHC	Buxhet vendor, transfertë e kushtëzuar sektoriale	Nr. mësues ndihmës të angazhuar; Raporti i mësuesve ndihmës me numrine fëmijëve me aftësi të kufizuara (një mësues për një fëmijë)
Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese dhe këshilluese në institucionet arsimore <i>Krijimi dhe fuqizimi i strukturave të përfqësimit dhe këshillimit në kopshte dhe shkolla, duke përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit. Aktiviteti synon rritjen e transparencës, përfshirjes dhe bashkëpunimit ndërmjet stafit arsimor, prindërve dhe komunitetit.</i>	2025–2026	Njësia për Arsimin, Drejtuesit e IA	Prindër, komuniteti lokal	Buxhet vendor	Nr. institucioneve me struktura funksionale 35 kopshte dhe 47 shkolla.
Ofrimi i shërbimit psiko-social në kopshte <i>Sigurimi i një shërbimi psiko-social të rregullt dhe të specializuar për fëmijët e moshës parashkollore, në partneritet me zyrën e shërbimit social të bashkisë. Ky shërbim do të ndihmojë në identifikimin</i>	2025–2028	Njësia për Arsimin, Zyra e Shërbimit Social	OSHC, specialistë të licencuar	Buxhet vendor, projekte me financim të huaj	Nr. kopshte me shërbim psiko-social aktiv (35 kopshte); <i>Nr. i personelit të dedikuar për shërbimin psikosocial në kopshte</i>

<i>dhe adresimin e vështirësive emocionale, sociale apo zhvillimore të fëmijëve. Një psikolog do të jetë i angazhaur për kopshtet</i>					
Mbështetja e nxënësve nga familjet në nevojë <i>Zbatimi i programeve ndihmëse për nxënësit që vijnë nga familje me vështirësi ekonomike, duke përfshirë ofrimin e pajisjeve shkollare, transportit, ushqimit apo shërbimeve të tjera që lehtësojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë në arsim.</i>	2025–2028	Njësia për Arsimin	Drejtuesit e shkollave dhe kopshteve, OSHC	Buxhet vendor, financim donatorësh	Nr. nxënësve përfitues; Nr. shkollave dhe kopshteve të mbuluara (35 gjithsej)
Mbështetja e nxënësve me rezultate të shkëlqyera <i>Vlerësimi dhe motivimi i nxënësve me arritje të larta akademike përmes bursave, shpërblimeve apo mundësive për pjesëmarrje në konkurse kombëtare, me synim nxitjen e ekselencës dhe talentit të ri.</i>	2025–2028	Njësia përgjegjëse për arsimin; Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale	Shkollat, Njësitë Administrative, OJQ	Buxhet vendor + donacione + projekte sociale	Nr. i nxënësve (vajza/djem) nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel të mbështetur

Qëllimi 3 (Q3)– Të zhvillohen dhe të institucionalizohen aktivitete të rregullta kulturore, sportive, mjedisore dhe ndërgjegjësuere në të gjitha institucionet arsimore, me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve dhe mbështetjen e stafit pedagogjik, prindërve dhe komunitetit, me qëllim nxitjen e zhvillimit të përgjithshëm, forcimin e bashkëpunimit shkollë–familje–komunitet dhe promovimin e vlerave të diversitetit, solidaritetit dhe përfshirjes sociale.

Objektivi specifik O3.1 Të organizohen rregullisht aktivitete kulturore, sportive dhe ndërgjegjësuere (si ditë tematike, ekspozita, aktivitete mjedisore dhe komunitare), me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve dhe mbështetjen e institucioneve arsimore, Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Adem Hoxha” dhe komunitetit, për të nxitur zhvillimin e përgjithshëm dhe integrimin social të tyre.

Aktivitete	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Treguesit e matjes së progresit
Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, lojëra edukative dhe mbështetje emocionale në institucionet e Arsimit në bashkëpunim me Qendrën Kulturore “Adem Hoxha”: <i>(Bashkia mbështet aktivitetet jashtëshkollore të organizuara nga institucionet arsimore të parashikuara në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë për vitin shkollor, i cili miratohet për çdo vit.)¹</i>	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të Shoqërisë Civile, Qendra Kulturore “Adem Hoxha”	Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirëse;
Aktivitetet e sugjeruara për kopshtet dhe shkollat, mbështetur në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë					

¹ Mbështetja me fonde të sigurohet edhe në zbatim të Udhëzimit të përbashkët nr. 11, datë 27.5.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë. Ky dokument përcakton rregullat dhe procedurat për menaxhimin e buxheteve të shkollave. Ai siguron që menaxhimi i fondeve buxhetore të jetë transparent dhe në përputhje me ligjet në fuqi, duke ndihmuar shkollat të menaxhojnë më mirë shpenzimet e tyre. Roli i Bashkisë është përcaktuar si aktor që vë fonde në dispozicion, si dhe lidhet edhe me proceset inventarizuese apo asistencë për zhvillim procedurash.

1. 23–30 Shtator – Java Evropiane e Sportit  Loja sportive në oborrin e kopshtit (loja popullore)  Ushtrime në natyrë (gimnastikë)  Loja të ndryshme lëvizore, Gara me biçikleta, etj.)	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
2. Prill–Maj – Java Olimpikë  Loja të ndryshme sportive (stafeta me flamuj, topa)  Gara vrapimi, midis kopshteve në grupe  Gara me biçikleta	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje donatorësh	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
3. 20 Nëntor – Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve  Bisedë, postera, aktivitete në natyrë (Kam të drejtë të luaj)  Ekspozitë me materiale të përgatitura nga fëmijët “Të drejtat e mia”  "Unë mbroj të drejtat e mia" (bisedë)	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
4. Dita e Luftës Kundër Bullizmit (21 nëntor)  Bisedë me fëmijët					
1. Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe  Postera me gjuhën shqipe & ilustrime  Koncert për gjuhën shqipe (Gjuha jonë sa e mirë)	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
2. Dita Ndërkombëtare e Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (3 dhjetor)	0	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët

- Biseda sensibilizuese për fëmijët me nevoja të veçanta - Loja me role (si t'i ndihmojmë shokët me nevoja të veçanta) - Ekspozitë me punime të përgatitura nga fëmijët me AK				Organizata shoqërisë Civile të	vulnerabël) që bëhen pjesë;
3. Dita Botërore e Gjuhës Amtare Vizitë në bibliotekë	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata shoqërisë Civile të	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
4. Dita Botërore e Ujit (UNESCO 22 mars) - Rëndësia dhe vlerat e ujit (bisedë, prezantime) “Uji është jetë” (Postera, eksperiment me ujë) - Bisedë për vlerat e ujit	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata shoqërisë Civile të	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
5. Dita Ndërkombëtare e Romëve Bisedë për fëmijët romë	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata shoqërisë Civile të	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
6. Zakonet dhe traditat e romëve	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata shoqërisë Civile të	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
7. Dita Botërore e Librit (23 prill) - Ne dimë të bëjmë libra (aktivitet krijues) - Vizitë në bibliotekë - Dhuro një libër, hap një dritare (fushatë sensibilizuese)	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata shoqërisë Civile të	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;

8. Dita Botërore e Mjedisit (5 qershor) ✚ Ekspozitë me mjete të riciklueshme ✚ Mbrojmë tokën, planetin tonë (projekt) ✚ Mbjellim lule në oborrin e kopshtit ose në vazo (aktivitet praktik) ✚ Mbajmë pastër mjedisin ku mësojmë e luajmë (aktivitet praktik, bisedë) ✚ Ekskursion në lulishten e qytetit	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
9. Pedalo për Turizëm dhe Kulturë në bashkëpunim me QKF ✚ Pedalim me biçikleta në pedonalen e qytetit ✚ Ekspozitë me punime, vizatime dhe postera	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
10. Yjet e Vallzimit në bashkëpunim me QKF ✚ Konkurs midis kopshteve të qytetit	Çdo vit	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;
11. Pedalo Kuq e në bashkëpunim me QKF ✚ Marshim me biçikleta të fëmijëve të kopshtit me rastin e Festave Kombëtare	0	Shkollat/kopshtet	Prindër, OJQ, MAS	Buxhet vendor, mbështetje Organizata të shoqërisë Civile	Numër fëmijësh/nxënesh (përfshi fëmijët vulnerabël) që bëhen pjesë;

10. Plani i investimeve kapitale

Plani i investimeve kapitale për arsimin parauniversitar dhe të mesëm të përgjithshëm për periudhën **2025–2028** synon të sigurojë kushte të qëndrueshme, moderne dhe të sigurta për mësimdhënie e mësimnxënie, në përputhje me objektivat strategjike të zhvillimit të arsimit në Bashki.

Investimet e planifikuara janë të orientuara drejt përmirësimit të infrastrukturës arsimore, modernizimit të mjediseve të mësimi dhe pajisjes së tyre me teknologji bashkëkohore, me synim rritjen e cilësisë së arsimit dhe sigurimin e aksesit të barabartë për të gjithë nxënësit.

Prioritetet kryesore të planit përfshijnë:

- **Rikonstrukcioni e plotë të infrastrukturës shkollore**, duke nisur me ndërhyrje në Shkollën 9-vjeçare “35 Vjetori i Çlirimit”, për të siguruar ambiente funksionale, të sigurta dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor.
- **Blerjen e pajisjeve bashkëkohore**, përfshirë pajisje informatike dhe pajisje të tjera mësimore për arsimin parashkollor, me qëllim modernizimin e metodave të mësimdhënies dhe krijimin e një mjedisi stimulues për fëmijët.

Planifikimi buxhetor për periudhën afatmesme 2026–2028 (në mijë lekë) përfshin:

1. **Rikonstrukcioni i Shkollës 9-vjeçare “35 Vjetori i Çlirimit”** – 88,460 (2026) + 46,740 (2027) = **135,200**
2. **Blerje pajisje informatike dhe pajisje të tjera shkollore për arsimin parashkollor** – 5,000 (2026) + 5,000 (2027) + 18,000 (2028) = **28,000**

Totali i investimeve për periudhën 2026–2028 arrin në **163,200 mijë lekë**, duke reflektuar angazhimin e Bashkisë për të investuar në cilësinë e infrastrukturës dhe pajisjeve arsimore si bazë për një proces mësimor efektiv dhe gjithëpërfshirës.

11. Monitorimi dhe vlerësimi

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parauniversitar kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

Indikatorët e Performancës

Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjikë. Ata janë të ndërlidhur me çdo kategori aktivitetsesh në planin e veprimit dhe do të përdoren për matjen e progresit të përvitshëm. Këta përfshijnë:

- Numrin e institucioneve të rikonstruara ose me kushte të përmirësuara;
- Numrin i kopshteve (hapësirave) të reja funksionale;
- Rritjen e regjistrimeve në kopshte dhe përfshirjen e fëmijëve nga grupe në nevojë;
- Numrin e mësuesve dhe edukatorëve të trajnuar;
- Cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e mjeteve didaktike dhe teknologjisë;
- Numrin e aktiviteteve jashtëmësimore dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në to;
- Mbështetjen sociale për fëmijët në nevojë (ushqim, mjete, shërbime psiko-sociale);
- Eficienca në furnizim, mirëmbajtje dhe shërbime mbështetëse.

Planifikimi i vlerësimit të progresit

Progresi i planit do të vlerësohet përmes mekanizmave të strukturuar të raportimit dhe analizës, të cilët do të jenë të integruar në ciklin e planifikimit buxhetor dhe vendimmarrjes vendore. Vlerësimi do të përfshijë:

- Raportime vjetore mbi realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- Matjen e ndikimit të investimeve në infrastrukturë dhe cilësi shërbimi;
- Analizën e të dhënave të mbledhura përmes monitorimit në terren;
- Vlerësimin e përmirësimit të qasjes, përfshirjes dhe mjedisit të të nxënës;
- Ndërlidhjen e progresit me planifikimin e ardhshëm afatmesëm.

Përfshirja e aktorëve të jashtëm

Për të garantuar objektivitetin, transparencën dhe përmirësimin e vazhdueshëm, do të sigurohet përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm, si:

- Ekspertë të pavarur në fushën e arsimit, të ftuar për të kryer vlerësime tematike;
- Organizata joqeveritare që merren me cilësinë e arsimit dhe përfshirjen sociale;
- Këshillat e prindërve, drejtuesit e shkollave dhe komunitetet vendore;
- Njësitë e statistikës/performances dhe monitorimit të bashkisë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave;
- Partnerë ndërkombëtarë në kuadër të projekteve të mbështetura financiarisht.

Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit

Monitorimi i planit do të realizohet në dy drejtime kryesore:

1. **Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara**
2. **Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në komunitetin arsimor**

Monitorimi i realizimit të aktiviteteve

Çdo aktivitet i planit do të vlerësohet në bazë të një sistemi pikëzimi nga 0 deri në 10, ku:

- **0** – Aktiviteti nuk ka nisur.
- **1–9** – Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.
- **10** – Aktiviteti është realizuar plotësisht sipas planifikimit.

Për secilin objektiv strategjik të planit, do të përcaktohet numri total i pikëve maksimale, duke shumëzuar numrin e aktiviteteve të planifikuara për objektivin përkatës me 10 (p.sh., 5 aktivitete x 10 = 50 pikë maksimale për objektivin).

Gjatë zbatimit, pikët reale të arritura për çdo aktivitet do të regjistrohen, dhe më pas do të përmbledhen në nivel objektiv. Kjo do të mundësojë llogaritjen e përqindjes së realizimit të secilit objektiv në kohë reale:

Përqindja e realizimit të objektivit = (Pike të realizuara / Pike maksimale) × 100

Ky mekanizëm do të sigurojë një vlerësim të qartë, të matshëm dhe të krahasueshëm për zbatimin e planit përgjatë viteve.

Vlerësimi i ndikimit në komunitet

Për të matur ndikimin e aktiviteteve në komunitet, do të monitorohet shkalla e pjesëmarrjes së institucioneve arsimore dhe fëmijëve në zbatimin e tyre.

Për çdo aktivitet do të vendosen targete të matshme:

- Numri i kopshteve dhe shkollave të synuara.
- Numri i fëmijëve të parashikuar për përfshirje (në kopsht dhe shkollë, sipas rastit).

Në përfundim të zbatimit të çdo aktiviteti, do të regjistrohet:

- Numri real i institucioneve që morën pjesë (në kopsht ose shkollë).
- Numri real i fëmijëve të përfshirë.

Në rastet kur aktiviteti synon vetëm një kategori (p.sh. vetëm kopshtet), pjesëmarrja për kategorinë tjetër do të konsiderohet 0.

Për çdo aktivitet do të llogaritet përqindja e pjesëmarrjes së arritur sipas formulës:

Përqindja e pjesëmarrjes = (Numri real i pjesëmarrësve / Numri target) × 100

Ky tregues do të ndihmojë në vlerësimin e shkallës së përfshirjes dhe impaktit që ka pasur secili aktivitet në komunitetin arsimor.

12. Rishikimi dhe përshtatja e planit

Rishikimi dhe përshtatja e planit janë mekanizma thelbësorë për të siguruar vazhdimësinë, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të planifikuara në fushën e arsimit parauniversitar në Bashkinë Gramsh. Këto procese shërbejnë për të ruajtur koherencën midis objektivave të planit, nevojave reale në terren dhe zhvillimeve të reja institucionale, ligjore apo sociale.

Procesi i rishikimit

Rishikimi i planit do të bëhet në mënyrë të strukturuar dhe të paracaktuar, me qëllim që të vlerësohet në mënyrë periodike efektiviteti i masave dhe aktiviteteve të ndërmarra. Planifikohen këto forma rishikimi:

- **Rishikimi vjetor** – i fokusuar në përditësimin e planit të veprimit dhe buxhetit vjetor në funksion të rezultateve dhe ndryshimeve të kontekstit;
- **Rishikimi afatmesëm (në fund të vitit 2027)** – për të analizuar realizimin e objektivave strategjike, performancën e indikatorëve dhe për të orientuar masat për vitin 2028;
- **Rishikime të jashtëzakonshme**, në rast të ndryshimeve madhore (si reformë e kuadrit ligjor, emergjenca, ndryshime buxhetore të rëndësishme).

Ky proces do të kryhet në mënyrë të ndërsektoriale, me pjesëmarrjen e drejtorive përgjegjëse, përfaqësuesve të institucioneve arsimore dhe aktorëve të tjerë vendorë.

Përshtatja e masave dhe aktiviteteve

Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga monitorimi dhe vlerësimi i planit, si dhe në konsultimet me komunitetin arsimor, do të ndërmerren përshtatje të nevojshme në:

- **Aktivitete konkrete** – duke përmirësuar përmbajtjen, kohëzgjatjen, mënyrën e zbatimit apo përgjegjësit;
- **Alokimin e burimeve** – në rast se disa fusha kërkojnë më shumë mbështetje për të arritur objektivat;
- **Prioritetet vjetore** – në përputhje me nevojat emergjente të fëmijëve, stafit arsimor apo komunitetit lokal;
- **Metodologjinë e zbatimit** – duke integruar praktikat më të mira dhe rekomandimet e vlerësimeve të jashtme.

Ky fleksibilitet në përshtatje synon të sigurojë që plani të mos mbetet një dokument statik, por të jetë një instrument dinamik, funksional dhe i orientuar drejt rezultateve reale për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Bashkinë Gramsh.

13. Raportimi dhe transparenca

Zbatimi i Planit të Arsimit Parauniversitar do të shoqërohet me mekanizma të qartë raportimi dhe transparence, për të garantuar përgjegjshmëri institucionale dhe përfshirje qytetare në vlerësimin e progresit.

- **Raportimi i progresit** do të realizohet përmes raporteve periodike vjetore, të cilat do të përfshijnë ecurinë e zbatimit të objektivave, sfidat e hasura dhe masat korrigjuese të ndërmarra nga njësitë përkatëse.
- **Përfshirja e publikut** do të sigurohet përmes publikimit të raporteve dhe rezultateve në faqen zyrtare të bashkisë, organizimit të takimeve konsultative me komunitetin dhe mundësimin të pjesëmarrjes qytetare në propozimin dhe vlerësimin e masave për përmirësimin e sistemit arsimor.

14. Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar

Kuadri Kushtetues dhe ligjor i përgjithshëm

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, neni 57, pika 1
- **Ligji Nr. 69/2012**, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me **Ligjin Nr. 48/2018**
- **Ligji Nr. 139/2015**, “Për Vetëqeverisjen 0Vendore”
- **Ligji Nr. 9936/2008**, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 68/2017**, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- **Ligji Nr. 9632/2006**, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar 0

Arsimi Parashkollor dhe i detyrueshëm (Bazë)

- **Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020**, “Për miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare”
- **Udhëzim Nr. 14, datë 10.7.2023**, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore në arsimin parauniversitar”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MEKI nr. 13, datë 10.07.2024**, “Për vitin shkollor 2024–2025 në sistemin arsimor parauniversitar”
- **Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018**, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”
- **Urdhër nr. 199, datë 07.05.2024**, “Për miratimin e Kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit”

Përfshirja dhe mbrojtja e fëmijëve

- **Ligji Nr. 121/2016**, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- **Ligji Nr. 18/2017**, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025**
- **Udhëzim Nr. 21, datë 08.08.2014**, “Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë”
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MShMS nr. 658, datë 23.09.2019**, “Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet”

Shërbimi psiko-Social dhe ërfshirja Sociale

- **Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020**, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar”
- **Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor**, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendore

15. Aneks 2: Numri i banorëve sipas njësive administrative dhe gjinisë (Censusi 2023)

Emri i Njesise Administrative	Gjinia	Numri i banoreve
Pishaj	Femer	1640
	Mashkull	1701
Kodovjat	Femer	1436
	Mashkull	1479
Kukur	Femer	1172
	Mashkull	1430
Kushovë	Femer	562
	Mashkull	538
Lenie	Femer	430
	Mashkull	582
Poroçan	Femer	1006
	Mashkull	959
Skënderbegas	Femer	899
	Mashkull	1101
Sult	Femer	774
	Mashkull	736
Tunjë	Femer	921
	Mashkull	1016
Gramsh	Femer	3430
	Mashkull	3356

16. Aneks 3 Numri i banorëve të rinj sipas njësive administrative dhe grupmoshës

Emri i Njesisë Administrative	Grupmosha	Numri i banoreve
Pishaj	3-4 vjeç	31
	4-5 vjeç	19
	5-6 vjeç	22
	6-15 vjeç	199
	15-18 vjeç	38
Kodovjat	3-4 vjeç	16
	4-5 vjeç	22
	5-6 vjeç	16
	6-15 vjeç	181
	15-18 vjeç	45
Kukur	3-4 vjeç	19
	4-5 vjeç	12
	5-6 vjeç	17
	6-15 vjeç	126
	15-18 vjeç	31
Kushovë	3-4 vjeç	5
	4-5 vjeç	3
	5-6 vjeç	3
	6-15 vjeç	31
	15-18 vjeç	0
Lenie	3-4 vjeç	4
	4-5 vjeç	4
	5-6 vjeç	6
	6-15 vjeç	26
	15-18 vjeç	5
Poroçan	3-4 vjeç	5
	4-5 vjeç	9
	5-6 vjeç	2
	6-15 vjeç	72
	15-18 vjeç	24
Skënderbegas	3-4 vjeç	4
	4-5 vjeç	4
	5-6 vjeç	8
	6-15 vjeç	64
	15-18 vjeç	15
Sult	3-4 vjeç	2
	4-5 vjeç	6
	5-6 vjeç	3
	6-15 vjeç	17
	15-18 vjeç	0
Tunjë	3-4 vjeç	4
	4-5 vjeç	2
	5-6 vjeç	2

Gramsh	6-15 vjeç	32
	15-18 vjeç	3
	3-4 vjeç	70
	4-5 vjeç	65
	5-6 vjeç	147
	6-15 vjeç	874
	15-18 vjeç	370

17. Aneks 4 Numri i banorëve të rinj sipas grupmoshës

Grupmosha	Numri i banorëve
0-4 vjeç	702
5-9 vjeç	838
10-14 vjeç	952
15-19 vjeç	999

18. Aneks 5 Numri shkollave (sipas kategorisë) dhe numri i kopshteve, sipas njësive administrative

Njësia Administrative	Shkolla Fillore	Shkolla 9-vjeçare	Shkolla të Mesme	Total shkolla	Kopshtet
Pishaj	4	6	1	11	11
Kodovjat	1	3	1	5	4
Kukur	1	4	1	6	6
Kushovë	2	2	0	4	2
Lenie	0	1	1	2	2
Poroçan	2	1	1	4	1
Skënderbegas	3	1	1	5	4
Sult	1	2	0	3	1
Tunjë	0	2	1	3	1
Gramsh (Qendra)	0	3	1	4	3
Total	14	25	8	47	35